



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 163, datë 29.09.2021

PËR

MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “MAZARS” SH.P.K., PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A., PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2021

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 123 dhe 124, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Mazars” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a., për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2021.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE